



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 603/20
615/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenkovic - Kryetar panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: “Grami ” SH.P.K - Prishtinë & “Albkos Safety” SH.P.K – Fushë Kosovë , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: “PMC ” SH.P.K – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Kompresor 250 L-min”, me nr. të prok: 616-20-2403-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë” (KK.P), më datën: 08.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: “Grami ” SH.P.K - Prishtinë & “Albkos Safety” SH.P.K – Fushë Kosovë , kundër njoftimit për dhënie të kontratës , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Kompresor 250 L-min”, me nr. të prok: 616-20-2403-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë” (KK.P) ,

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Kompresor 250 L-min”, me nr. të prok: 616-20-2403-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë” (KK.P) , dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat grupit të operatorëve ekonomik ankues: “Grami ” SH.P.K - Prishtinë & “Albkos Safety” SH.P.K – Fushë Kosovë, i aprovohen si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues: “Grami ” SH.P.K - Prishtinë & “Albkos Safety” SH.P.K – Fushë Kosovë, si palë e pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 28.08.2020 me nr. 603/20, dhe me 31.08.2020 me nr. 615/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: “PMC ” SH.P.K – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Kompresor 250 L-min”, me nr. të prok: 616-20-2403-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë” (KK.P),duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 10, 28, 52 , 56, 59, 60, 69, 72 , si dhe nenin 108/A të LPP-së, te ankesa me nr. 603/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 6, 7, 28, 52, 56, 59, 60 , si dhe nenin 69 të LPP-së, te ankesa me nr. 615/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.09.2020, ka autorizuar ekspertët shqyrtues-teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Ekspertët shqyrtues-teknik të prokurimit në raportin e dt: 25.09.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “Grami” SH.P.K – Prishtinë.

Përgjigje në Pretendimet ankimore (neni 113)

Pretendimet ankimore 1 – Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues ku thuhet se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësua specifikacionet e kërkuar ne DT, te kompresori model PACIFIC E mungojnë parametrat teknik, si vijon:

Ne DT është kërkuar:

- Karakteristikat e kompresorit Kapaciteti i mbushjes së bombolave ... 4 x 300 bar

Pastrimi i sistemit ... P 31/350 Ndërsa OE PMC SH.P.K ka ofruar:

Te përshkrimi opcionale Gypa standard për mbushja ka 2 – gete standarde mbushëse te ajrit 2, ndërsa 4 me opsione shtese (me 2 pajisje shtese plotësuese).

Presioni dyfish me reduktues te presionit 225 bar (maksimumi 2 gete) 330 bar(maksimumi 2 gete) Pra, kompresori i ofruar nga PMC s SH.P.K - nuk ka kapacitetin e mbushjes se bombolave 4 x 300 bar Ne kompresorin e ofruar nga PMC SH.P.K Mungon Klasifikimi mbrojtjes, minimum IP55 qe është parametër primar për pune dhe funksionim te kompresorit ne te gjitha kushtet, si (teknike, atmosferike, me ngarkese, etj...), për pune ne kohe te gjate dhe pandërprere për mbushjen e bombolave te oksigjenit.

Eksperti teknik sqaron se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kriterin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues pasi qe kompresori i ofruar ne katalog janë 2 dalje standarde (kurse 2 dalje tjera janë pajisje shtese, gjë qe e kompleksoj konstruksionin e kompresorit dhe është mase (peshe) shtesë ne kompresor).

Po ashtu është kërkuar nga AK-ja Klasifikimi mbrojtjes, minimum IP55 , OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar ne katalog e qe është e rëndësishme për funksionimin e kompresorit.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues ku thuhet se është kërkuar ne DT, te kompresori PACIFIC E i OE PMC SH.P.K mungojnë parametrat teknik:

Karakteristikat e bllokut të kompresorit

Valvule siguruese pas çdo faze

Valvule siguruese e presionit përfundimtar e aprovuar me TUV

Filtri thithës mikronik 10 µm

Karakteristikat e pajisjes mbushëse PN 300 bar

Valvule me ventilim apo shkarkim të shtypjes, lidhësja G 3/8" konform normave DIN 477, DIN EN 144-2 dhe manometër PN300 Katër koka mbushëse nga 300 bar

Eksperti teknik sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ne katalog mungoj parametrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues

Karakteristikat e bllokut të kompresorit

Valvule siguruese pas çdo faze

Valvule siguruese e presionit përfundimtar e aprovuar me TUV

Filtri thithës mikronik 10 µm

Karakteristikat e pajisjes mbushëse PN 300 bar

Valvule me ventilim apo shkarkim të shtypjes, lidhësja G 3/8" konform normave DIN 477, DIN EN 144-2 dhe manometër PN300 Katër koka mbushëse nga 300 bar

Gjithashtu Eksperti teknik sqaron se ne DT është kërkuar:

- Karakteristikat e pajisjes monitoruese

Sistem i kompjuterizuar i cili numëron orët e punës dhe benë matjen e saturimit të filtrit pastrues.

- Sistemi kontrollues i kompresorit për zbrazjen automatike të kondensimit apo kullimin

Mbrojtje elektrike e elektro-motorit.

Ndërprerësi i presionit duhet të ndalë kompresorin në presionin përfundimtar

Kullimi i të gjithë ndarësve mes fazave individuale dhe gjithashtu ndarësit përfundimtar, operimi (intervali standard i kullimit minimum çdo 15 minuta)

Fillimi i shkarkuar i integruar (kullimi automatik në shkyçje të pajisjes)

Rezervuari i grumbullimit të kondensimesh 10 litra, me heshtës dhe kapacitet rreth 5 litra të kondensimesh për asgjësim ne mjedis.

Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ne katalogun te kompresori PACIFIC E i OE PMC SHPK mungojnë parametrat teknik te specifikuar sipas kërkesës se AK-se

Po ashtu Eksperti teknik sqaron se ne DT janë kërkuar standardet:

EC 2006/42/EC

EU 2006/42/EC

EU 2014/35/EU

EU (EMV) 2014/30/EU

Shtëpiza e filtrit e standardizuar sipas rregulloreve për parandalimin e aksidenteve AD-2000

Shtëpiza e filtrit e aprovuar në kordinim me AD-2000 dhe DGRL2014/68/EU

I prodhuar në përputhje me rregulloret për parandalimin e aksidenteve sipas DIN, VDE, TÜV.

Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ne katalogun te kompresori PACIFIC E i OE PMC SH.P.K mungojnë standardet e kërkuara nga AK-ja. **Prova 1:** Katalog me COMPRESSOR PACIFIC E, te OE PMC.

Pretendimet ankimore 2, Pretendimi tjetër ankimore për piken 9.1 & 9.2 , lidhur me projektet e realizuara ka kërkuar referenca për projekte te ngjashme me natyrën e aktiviteti te prokurimit, rrjedhimisht vlerësimi ynë është se te dy ofertuesit e këtij aktiviteti te prokurimit e plotësojnë kërkesën e AK-se.

Pretendimet ankimore 3, Lidhur me pretendimin ankimor ku thuhet se OE PMC me oferte nuk ka dorëzuar Katalog, ndërsa ne Deklaratën e Aneksi 1 për Specifikimet teknike te detyrueshme ka deklarua se përmbush kushtet e DT.

Eksperti teknik sqaron se katalogun qe ka dorëzuar për COMPRESSOR PACIFIC E nuk përmbush te gjitha specifikimet teknike te kërkuar nga AK-ja.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: “Albkos Safety” SH.P.K – Fushë Kosovë ,

Pretendimet ankimore 1, - Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues ku thuhet se AK KOMUNA E PR/SH7INËS, më 14.08.2020 ka njoftuar se ka propozuar për la shpërblyer me kontratë OE "PMC" SII.P.K. — Prishtinë, me çmimin prej/ 4.900,00 EUR, kurse ka eliminuar nga aktiviteti i mëtutjeshëm i prokurimit kompaninë tonë "ALBKOS SAFETY" SH.P.K, edhe përkundër çmimit prej /3.705,00 EUR i cili është dukshëm më i ultë se sa ai i OE "PMC" SII.P.K., me arsyetimin në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar.

Nuk i kemi plotësuar kërkesat teknike sipas specifikimit teknik të dhënë sipas Dosjes së Tenderit pasi që në specifikimin teknik të Dosjes është kërkuar që kompresori prej 250 / min - pesha maksimale të jetë /40 kg, ndërsa katalogu që ju keni ofruar dëshmon se pesha maksimale për kompresorin që keni ofruar është 158 kg. Eksperti teknik sqaron se OE ankues “ALBKOS SAFETY” SH.P.K., në katalog ka ofertuar kompresorin 250 I min me Model CTP 280 E3 me peshë 128 kg që e plotëson kërkesën e Autoritetit Kontraktues. Kërkesa për rishqyrtim ka qenë vetëm pesha e kompresorit, ku Autoriteti Kontraktues e ka pranuar se është bërë lëshim teknik.

Eksperti teknik sqaron se Autoriteti Kontraktues ka bërë korrigjimin e letrës standarde për Eliminim, ku kërkesën për Rishqyrtim ka qenë vetëm pesha e kompresorit e që OE ankues c ka përmbushur kërkesën e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues që bërë korrigjimin e letrës standarde për Eliminim merr vendim duke aprovuar pjesërisht kërkesën e OE ankues. Në arsyetimin e vendimit Autoriteti Kontraktues thotë se ju si operator ekonomik eliminoheni për arsye se Kompresori i ofruar ka vetëm 2 valvule mbushëse dhe jo (4) katër siç është kërkuar në përshkrimin të çmimit - ashtu siç shihet në katalog dhe në specifika të katalogut që ju keni ofertuar ka vetëm 2 valvule mbushëse.

Eksperti teknik sqaron se OE ankues nuk e ka ofruar katalogun askund nuk është potencuar (2) apo (4) katër valvule mbushëse. OE ankues në ankesë ka sjell disa prova që dëshmojnë se kompresori është i pajisur me 4 valvule (kyçje) për mbushjen e bombolave, kurse presioni prej 200 ose 300 bar bëhet sipas kërkesës së klientit. Gjithashtu Eksperti teknik sqaron se me datë 28.08.2020 OE ankues e dëshmon në lista c çmimeve e vitit 2019, të cilën c ka pranuar me email nga prodhuesi, më 15.02.2019, ku shihet qartë që kjo seri e kompresorëve standard është e pajisur me “rampë mbushëse 4x200bar ose 4x300 bar”. Dëshmi tjetër nga OE ankues me datën 10.06.2020, përmes së cilit prodhuesi ka dërguar dok. për ofertim, me ç’rast ka propozuar për të ofertuar me njërin nga dy kompresorët CTP-F 280 E3 dhe CTP 280 E3, në të cilin shihet qartë se të dy kompresorët janë të pajisur me nga 4 valvule me presion 300 bar.

Technical Specifications

Model		CTP 160 E3	CTP 210 E3	CTP 280 E3	CTP 320 E3
Delivery Rate	[lit/min]	160	210	280	320
Speed	[r.p.m.]	1050	1200	1600	1780
Noise level	[dB(A)]	80	80	82	82
Dimension	[LxWxH in mm]	870 x 440 x 740	870 x 440 x 740	870 x 440 x 740	870 x 440 x 740
Weight	[kg]	125	125	128	140
Power	[kW]	4	4	5,5	7,5
Model		CTP 160 P	CTP 210 P	CTP 280 P	CTP 320 P
Delivery Rate	[lit/min]	160	210	280	320
Speed	[r.p.m.]	1050	1200	1600	1780
Noise level	[dB(A)]	87	87	88	89
Dimension	[LxWxH in mm]	1170 x 600 x 660	1170 x 600 x 660	1170 x 600 x 660	1170 x 600 x 660
Weight	[kg]	158	158	158	158
Power	[kW]	6,6	6,6	6,6	8

Lidhur me pretendimet e OE ankues ku thuhet se AK nuk ka marrë parasysh deklaratën mbi specifikimet teknike të cilën ia kemi bashkangjitur ofertës tonë me rastin ofertimit, siç ka vepruar në të paktën në dy raste të tjera me operatorë të tjerë ekonomik, duke e konsideruar si të mjaftueshme një deklaratë të tillë, për I 'i cilësuar si të përgjegjshëm këta OE edhe atëherë kur ata kanë qenë të papërgjegjshëm.

Eksperti teknik sqaron se Autoriteti Kontraktues "Deklaratën mbi specifikimet teknike", për OE te rekomanduar për kontratë e ka konsideruar te mjaftueshme edhe pse në katalog mungoj parametrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Lidhur me pretendimin e OE ankues ku thuhet se me rastin e qasjes në dokumentacion, AK ka dhënë vetëm emailët e Operatorit Ekonomik dërguar AK (edhe ato jo të plota, sepse nuk shihen dokumentet e bashkangjitura), ndërsa nuk i ka dhënë emailat e Autoritetit Kontraktues të cilët ia ka dërguar Operatorit Ekonomik me përmes të cilave ka komunikuar me OE. Eksperti teknik sqaron se gjatë shqyrtimit të lëndës nuk ka hasur asnjë email që autoriteti Kontraktues ja ka dërguar OE te rekomanduar për kontratë, emailët e dërguara nga OE i rekomanduar për kontratë në asnjë email nuk shihet që ka te bashkangjitur Katalogun. Po ashtu Eksperti teknik sqaron se OE i rekomanduar për kontratë në ofertë nuk ka ofruar Katalog për kompresor 250 l, por vetëm një deklaratë që i përmbushi specifikimet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 25.08.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 28.08.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

0 1	Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opstina Pristina -Municipality of Prishtina	PRISHTINA
		&

Datë/a:	28.09.2020
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Ardian Behra, Kryesus i sekretariatit të OSHP-së
CC:	Hysni Muhadri - ekspert shqyrtues i prokurimit Halil Hoti - ekspert teknik
Përmes/Preko/Through:	Zekë Bardhë Udhëheqës i Prokurimit Av Ar 7
Nga/ Od/ From:	Nexhmi Mekolli, Zyrtar i larte per Prokurimit /C V/
Tema/ Subjekat/Subject:	Përgjigje për raportin ekspertit shqyrtues

Departamenti i Prokurimit i Komunës së Prishtinës ka pranuar Raportin e Ekspertit Shqyrtues Nr. 603/615/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi me kompresor 250 I - min me nr. të prokurimi: 616 20 069 121. andaj konfirmon se nuk e mbështetë propozimin e ekspertit shqyrtues. që ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar dhe që lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues edhe me datën 11.09.2020 është përgjigjur ne raportin e ekspertit shqyrtues dhe ka sqaruar te gjitha pretendimet e operatoreve ankues.

Konstatimi i ekspertit shqyrtues dhe teknik lidhur me pretendimet e OE, janë të pa bazuar për faktin që OE i propozuar për kontrate i ka plotësuar te gjitha kërkesat e kërkuara ne Njoftimin për kontrate dhe ne Dosjen 6 Tenderit.

AK gjate vlerësimit te ofertave ka respektuar te gjitha rregullat e LPP, te Udhëzuesit Operativ te PP, andaj edhe kërkon nga Paneli Shqyrtues qe ankesa e Operatorit Ekonomik te hedhet poshtë si e pabazuar dhe se Autoriteti kontraktues te vazhdoj me njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Ju faleminderit.

Operatorët Ekonomik “Grami ” SH.P.K – Prishtinë, me datë: 14.08.2020, me anë të parashtresës, kanë njoftuar OSHP-në, se pajtohen me mendimin e ekspertëve shqyrtues.

Operatorët Ekonomik, "Albkos Safety" SH.P.K – Fushë Kosovë , me datë: 25.08.2020, me anë të parashtresës, kanë njoftuar OSHP-në, se pajtohen me mendimin e ekspertëve shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, sqaron se ankesa është parashtuar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues ka analizuar pretendimet ankimore të OE ankues "Grami" SH.P.K – Prishtinë.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues ku thuhet se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar specifikacionet e kërkuara në DT, te kompresori model PACIFIC E mungojnë parametrat teknik, si vijon:

Ne DT është kërkuar:

- Karakteristikat e kompresorit Kapaciteti i mbushjes së bombolave ... 4 x 300 bar

Pastrimi i sistemit ... P 31/350 ndërsa OE PMC SH.P.K ka ofruar:

Te përshkrimi opcionale Gypa standard për mbushja ka 2 – gete standarde mbushëse të ajrit 2, ndërsa 4 me opsione shtese (me 2 pajisje shtese plotësuese).

Presioni dyfish me reduktues të presionit 225 bar (maksimumi 2 gete) 330 bar (maksimumi 2 gete) Pra, kompresori i ofruar nga PMC s SH.P.K - nuk ka kapacitetin e mbushjes së bombolave 4 x 300 bar. Në kompresorin e ofruar nga PMC SH.P.K mungon klasifikimi mbrojtjes, minimum IP55 që është parametër primar për punë dhe funksionim të kompresorit në të gjitha kushtet, si (teknike, atmosferike, me ngarkesë, etj...), për punë në kohe të gjata dhe pandërprere për mbushjen e bombolave të oksigjenit.

Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit teknik sqaron se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kriterin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues pasi që kompresori i ofruar në katalog janë 2 dalje standarde (kurse 2 dalje tjera janë pajisje shtese, gjë që e komplekson konstruksionin e kompresorit dhe është mëse (peshe) shtesë në kompresor).

Po ashtu është kërkuar nga AK-ja, klasifikimi mbrojtjes, minimum IP55, OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar ne katalog e qe është e rëndësishme për funksionimin e kompresorit.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues ku thuhet se është kërkuar ne DT, te kompresori PACIFIC E i OE PMC SH.P.K mungojnë parametrat teknik: Karakteristikat e bllokut të kompresorit, Valvule siguruese pas çdo faze, Valvule siguruese e presionit përfundimtar e aprovuar me TUV, Filtri thithës mikronik 10 µm, Karakteristikat e pajisjes mbushëse PN 300 bar

Valvule me ventilim apo shkarkim të shtypjes, lidhësja G 3/8" konform normave DIN 477, DIN EN 144-2 dhe manometër PN300 Katër koka mbushëse nga 300 bar

Paneli shqyrtues sqaron se OE të rekomanduar për kontratë ne katalog i mungojnë parametrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues- Karakteristikat e bllokut të kompresorit, Valvule siguruese pas çdo faze, Valvule siguruese e presionit përfundimtar e aprovuar me TUV, Filtri thithës mikronik 10 µm, Karakteristikat e pajisjes mbushëse PN 300 bar, Valvule me ventilim apo shkarkim të shtypjes, lidhësja G 3/8" konform normave DIN 477, DIN EN 144-2 dhe manometër PN300 Katër koka mbushëse nga 300 bar.

Paneli shqyrtues poashtu sqaron se ne DT është kërkuar:

- Karakteristikat e pajisjes monitoruese

Sistem i kompjuterizuar i cili numëron orët e punës dhe benë matjen e saturimit të filtrit pastrues.

- Sistemi kontrollues i kompresorit për zbrazjen automatike të kondensimit apo kullimin

Mbrojtje elektrike e elektro-motorit.

Ndërprerësi i presionit duhet të ndalë kompresorin në presionin përfundimtar

Kullimi i të gjithë ndarësve mes fazave individuale dhe gjithashtu ndarësit përfundimtar, operimi (intervali standard i kullimit minimum çdo 15 minuta)

Fillimi i shkarkuar i integruar (kullimi automatik në shkyçje të pajisjes)

Rezervuari i grumbullimit të kondensimesh 10 litra, me heshtës dhe kapacitet rreth 5 litra të kondensimesh për asgjësim në mjedis.

Ndërsa OE të rekomanduar për kontratë ne katalogun te kompresori PACIFIC E i OE PMC SHPK i mungojnë parametrat teknik te specifikuar sipas kërkesës se AK-se.

Paneli shqyrtues gjithashtu sqaron se ne DT janë kërkuar standardet: EC 2006/42/EC, EU 2006/42/EC, EU 2014/35/EU, EU (EMV) 2014/30/EU

Shtëpiza e filtrit e standardizuar sipas rregulloreve për parandalimin e aksidenteve AD-2000

Shtëpiza e filtrit e aprovuar në kordinim me AD-2000 dhe DGRL2014/68/EU

I prodhuar në përputhje me rregulloret për parandalimin e aksidenteve sipas DIN, VDE, TÜV.

Ndërsa OE të rekomanduar për kontratë ne katalogun te kompresori PACIFIC E i OE PMC SH.P.K i mungojnë standardet e kërkuara nga AK-ja.

Lidhur me pretendimin ankimor për piken 9.1 & 9.2, lidhur me projektet e realizuara AK ka kërkuar referenca për projekte te ngjashme me natyrën e aktiviteti te prokurimit, rrjedhimisht te dy ofertuesit e këtij aktiviteti te prokurimit e plotësojnë kërkesën e AK-se.

Lidhur me pretendimin ankimor ku thuhet se OE i rekomanduar PMC me oferte nuk ka dorëzuar Katalog, ndërsa ne Deklaratën e Aneksi 1 për Specifikimet teknike te detyrueshme ka deklaruar se përmbush kushtet e DT, paneli shqyrtues sqaron se katalogun qe ka dorëzuar për COMPRESSOR PACIFIC E nuk përmbush te gjitha specifikimet teknike te kërkuar nga AK-ja.

Paneli shqyrtues ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues “Albkos Safety” SH.P.K – Fushë Kosovë

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues ku thuhet se AK Komuna e Prishtinës, më 14.08.2020 ka njoftuar se ka propozuar për ta shpërblyer me kontratë OE "PMC" SH.P.K. — Prishtinë, me çmimin prej/ 4.900,00 EUR, kurse ka eliminuar nga aktiviteti i mëtutjeshëm i prokurimit kompaninë tonë "ALBKOS SAFETY" SH.P.K, edhe përkundër çmimit prej 3.705,00 EUR i cili është dukshëm më i ultë se sa ai i OE "PMC" SH.P.K., me arsyetimin në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar nuk i kemi plotësuar kërkesat teknike sipas specifikimit teknik te dhënë sipas Dosjes se Tenderit pasi qe ne specifikimin teknik te Dosjes është kërkuar qe kompresori prej 250 / min - pesha maksimale te jete /40 kg, ndërsa katalogu qe ju keni ofruar dëshmon se pesha maksimale për kompresorin qe keni ofruar është 158 kg.

Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues teknik sqaron se OE ankues “ALBKOS SAFETY” SH.P.K., në katalog ka ofertuar kompresorin 250 i min me Model CTP 280 E3 me peshë 128 kg që e plotëson kërkesën e Autoritetit Kontraktues. Në kërkesën për rishqyrtim ka qenë vetëm pesha e kompresorit, ku Autoriteti Kontraktues e ka pranuar se është bërë lëshim teknik. Paneli shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues ka bërë korrigjimin e letrës standarde për Eliminim, ku në kërkesën për Rishqyrtim ka qenë vetëm pesha e kompresorit e që OE ankues e ka përmbush kërkesën e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues që bërë korrigjimin e letrës standarde për eliminim ka marr vendim duke aprovuar pjesërisht kërkesën e OE ankues. Në arsyetimin e vendimit Autoriteti Kontraktues thuhet se ju si operator ekonomik eliminoheni për arsye se Kompresori i ofruar ka vetëm 2 valvule mbushëse dhe jo (4) katër siç është kërkuar në përshkrimin të çmimit - ashtu siç shihet në katalog dhe në specifika të katalogut që ju keni ofertuar ka vetëm 2 valvule mbushëse.

Paneli shqyrtues sqaron se OE ankues e ka ofruar katalogun dhe askund nuk është potencuar (2) apo (4) katër

valvule mbushëse. OE ankues në ankesë ka sjell disa prova që dëshmojnë se kompresori është i pajisur me 4 valvule (kyçe) për mbushjen e bombolave, kurse presioni prej 200 ose 300 bar bëhet sipas kërkesës së klientit. Gjithashtu paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit teknik sqaron se me datë 28.08.2020 OE ankues e dëshmon në lista e çmimeve të vitit 2019, të cilën e ka pranuar me email nga prodhuesi, më 15.02.2019, ku shihet qartë që kjo seri e kompresorëve standard është e pajisur me “rampë mbushëse 4x200bar ose 4x300 bar”. Dëshmi tjetër nga OE ankues është me datën 10.06.2020, përmes se cilit prodhuesi ka dërguar dokumentet për ofertim, me ç’rast ka propozuar për të ofertuar me njërin nga dy kompresorët CTP-F 280 E3 dhe CTP 280 E3, në të cilin shihet qartë se të dy kompresorët janë të pajisur me nga 4 valvule me presion 300 bar.

Lidhur me pretendimet e OE ankues ku thuhet se AK nuk ka marrë parasysh deklaratën mbi specifikimet teknike të cilën ia kemi bashkangjitur ofertës tonë me rastin ofertimit, siç ka vepruar në të paktën në dy raste të tjera me operatorë të tjerë ekonomik, duke e konsideruar si të mjaftueshme një deklaratë të tillë, për t’i cilësuar si të përgjegjshëm këta OE edhe atëherë kur ata kanë qenë të papërgjegjshëm.

Paneli shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues “Deklaratën mbi specifikimet teknike” për OE te rekomanduar për kontratë e ka konsideruar te mjaftueshme edhe pse në katalog mungojnë parametrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Lidhur me pretendimin e OE ankues ku thuhet se me rastin e qasjes në dokumentacion, AK ka dhënë vetëm emaillet e Operatorit Ekonomik dërguar AK (edhe ato jo të plota, sepse nuk shihen dokumentet e bashkangjitura), ndërsa nuk i ka dhënë emailat e Autoritetit Kontraktues të cilët ia ka dërguar Operatorit Ekonomik me përmes të cilave ka komunikuar me OE. Paneli shqyrtues sqaron se nga eksperti teknik gjatë shqyrtimit të lëndës nuk është hasur asnjë email që autoriteti Kontraktues ja ka dërguar OE te rekomanduar për kontratë. Në e-maillet e dërguara nga OE i rekomanduar për kontratë në asnjë email nuk shihet që ka të bashkangjitur Katalogun. Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë në ofertë nuk ka ofruar Katalog për kompresor 250 l, por vetëm një deklaratë që i përmbushi specifikimet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues vlerëson se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit AK nuk ka vepruar konform dispozitave të LPP-së më saktësisht nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform dispozitave të nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues vlerëson se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë ne

konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Z. Goran Milenkovic



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 /AK/ - "KK-Prishtinë" (KK.P),
- 1x1 / OE/ - "Grami " SH.P.K - Prishtinë &
- 1x1 /OE/ "Albkos Safety" SH.P.K – Fushë Kosovë ,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.